



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.23/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e : [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të parashtruara ndaj KQZ-së, për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHEN TË PABAZUARA ANKESAT ZL.Anr 23/2025 e parashtruar nga [REDACTED] ZL Anr.24/2025 e parashtruar nga [REDACTED] ZL.Anr.25/2025 e parashtruar nga [REDACTED] ZL.Anr 26/2025 e parashtruar nga [REDACTED] ZL.Anr 27/2025 e parashtruar nga [REDACTED], ZL.Anr 28/2025 e parashtruar nga [REDACTED] ZL.Anr.30/2025 e parashtruar nga [REDACTED] për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

Arsyetim

Më datë 09.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL.Anr.23/2025 nga [REDACTED] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka refuzuar aplikimin për regjistrim pa asnjë arsyetim të ligjshëm e drejta për të ushtruar të drejtën time kushtetuese për të votuar me post nga diaspora. Më tej në ankesë theksohet se ky vendim është i pabazuar sepse parashtruesi i ankesës ka ofruar prova të mjaftueshme: kopjen e pasaportës dhe dëftesën e regjistrimit për votuesit jashtë Kosovës.

Sipas parashtruesit të ankesës e drejta e tij për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr.08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas neni 10, paragrafi 4. Refuzimi i vetëm mbi bazën formale të e-mail adresës cenon këtë të drejtë. Dokumentet e tij të paraqitura përfshijnë të dhëna të qarta dhe të sakta mbi e-mail adresën, kopjen e pasaportës, dëftesën e regjistrimit si votues jashtë Kosovës, duke dëshmuar në mënyrë të pakontestueshme aplikimin e tij. Po ashtu ankuesi thekson se në asnjë dispozitë ligjore nuk është e përcaktuar si kusht i domosdoshëm që dokumenti i Republikës së Kosovës (letërnjoftim, pasaportë) të jetë i

vlefshëm (valid) në momentin e aplikimit për votim me post nga diaspora. Kjo provë është e mjaftueshme për të plotësuar kriterin e aplikimit si votues jashtë Kosovës, dhe kufizimi i të drejtës së votës mbi këtë bazë është i pajustificueshëm dhe përbën interpretim arbitrar nga ana e KQZ-sës dhe duhet të anulohet. Andaj, Kërkon nga PZAP-i, që të pranoj ankesën si të bazuar, dhe të obligojë KQZ-në të pranojë regjistrimin e tij si votues jashtë Kosovës, duke marrë parasysh provat e paraqitura si dëftesën e regjistrimit nga diaspora si dhe kopjen e letërnjoftimit të tij. Ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, Dëftesën e Regjistrimit si dhe kopjen e Pasaportës.

Më datë 09.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL.Anr.24/2025, nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka refuzuar pa njoftim dhe pa asnjë arsytim të ligjshëm për të ushtruar të drejtën time kushtetuese për të votuar me post nga diaspora. Më tej, në ankesë theksohet se ky vendim është i pabazuar sepse parashtruesi i ankesës ka ofruar prova të mjaftueshme: kopjen e pasaportës dhe dëftesën e regjistrimit për votuesit jashtë Kosovës.

Sipas parashtruesit të ankesës e drejta e tij për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr.08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas neni 10, paragrafi 4. Refuzimi i vetëm mbi bazën formale të e-mail adresës cenon këtë të drejtë. Dokumentet e tij të paraqitura përfshijnë të dhëna të karta dhe të sakta mbi e-mail adresën, kopjen e pasaportës, dëftesën e regjistrimit si votues jashtë Kosovës, duke dëshmuar në mënyrë të pakontestueshme aplikimin e tij. Po ashtu ankuesi thekson se në asnjë dispozitë ligjore nuk është e përcaktuar si kusht i domosdoshëm që dokumenti i Republikës së Kosovës (letërnjoftim, pasaportë) të jetë i vlefshëm (valid) në momentin e aplikimit për votim me post nga diaspora. Kjo provë është e mjaftueshme për të plotësuar kriterin e aplikimit si votues jashtë Kosovës, dhe kufizimi i të drejtës së votës mbi këtë bazë është i pajustificueshëm dhe përbën interpretim arbitrar nga ana e KQZ-sës dhe duhet të anulohet. Andaj, Kërkon nga PZAP-i, që të pranoj ankesën si të bazuar, dhe të obligojë KQZ-në të pranojë regjistrimin e tij si votues jashtë Kosovës, duke marrë parasysh provat e paraqitura si dëftesën e regjistrimit nga diaspora si dhe kopjen e letërnjoftimit të tij. Ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, Dëftesën e Regjistrimit si dhe kopjen e Pasaportës.

Më datë 09.09.2025 në ora 00:23, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL Anr 25/2025, nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se me datë 03.09.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar kundërshtimin administrativ me arsyetimin se adresa e tij nuk është vërtetuar. Më tej, në ankesë theksohet parashtruesja ka aplikuar për votim nga diaspora brenda afatit ligjor dhe se aplikimi i është miratuar nga KQZ, dhe si dëshmi i është dërguar dëftesa e aprovimit ku ka qenë e obliguar ta bashkëngjis me materialin e votimit. Tutje shton se në listën e publikuar nga KQZ më datë 28.09.2025 figuron emri i saj si aplikueses e suksesshme por në listën përfundimtare, emri i është tërhequr pa njoftim zyrtar. Sipas parashtrueses së ankesës e drejta e saj për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe me rregulloren e PZAP-së, nr.01/2025.

Më datë 09.09.2025 në ora 00:36, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL A.nr 26/2025 nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se me datë 03.09.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar kundërshtimin administrativ me arsyetimin se adresa e tij nuk është vërtetuar. Më tej, në ankesë theksohet parashtruesja ka aplikuar për votim nga diaspora brenda afatit ligjor dhe se aplikimi i është miratuar nga KQZ, dhe si dëshmi i është dërguar dëftesa e aprovimit ku ka qenë e obliguar ta bashkëngjis me

materialin e votimit. Tutje shton se në listën e publikuar nga KQZ më datë 28.09.2025 figuron emri i saj si aplikuses e suksesshme por në listën përfundimtare, emri i është tërhequr pa njoftim zyrtar. Sipas parashtrueses së ankesës e drejta e saj për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe me rregulloren e PZAP-së, nr.01/2025.

Më datë 09.09.2025 në ora 12:43, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL Anr 27/2025, nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se me datë 03.09.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar kundërshtimin administrativ me arsyetimin se adresa e tij nuk është vërtetuar. Më tej, në ankesë theksohet parashtruesja ka aplikuar për votim nga diaspora brenda afatit ligjor dhe se aplikimi i është miratuar nga KQZ, dhe si dëshmi i është dërguar dëftesa e aprovimit ku ka qenë e obliguar të bashkëngjis me materialin e votimit. Tutje shton se në listën e publikuar nga KQZ më datë 28.09.2025 figuron emri i saj si aplikuese e suksesshme por në listën përfundimtare, emri i është tërhequr pa njoftim zyrtar. Sipas parashtrueses së ankesës e drejta e saj për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe me rregulloren e PZAP-së, nr.01/2025.

Më datë 09.09.2025 në ora 12:46, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL Anr 28/2025 nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se me datë 03.09.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar kundërshtimin administrativ me arsyetimin se adresa e tij nuk është vërtetuar. Më tej, në ankesë theksohet parashtruesja ka aplikuar për votim nga diaspora brenda afatit ligjor dhe se aplikimi i është miratuar nga KQZ, dhe si dëshmi i është dërguar dëftesa e aprovimit ku ka qenë e obliguar ta bashkëngjis me materialin e votimit. Tutje shton se në listën e publikuar nga KQZ më datë 28.09.2025 figuron emri i saj si aplikuses e suksesshme por në listën përfundimtare, emri i është tërhequr pa njoftim zyrtar. Sipas parashtrueses së ankesës e drejta e saj për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe me rregulloren e PZAP-së, nr.01/2025.

Më datë 09.09.2025 në ora 04:51, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL Anr.30/2025 nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se me datë 03.09.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka refuzuar kundërshtimin administrativ me arsyetimin se adresa e tij nuk është vërtetuar. Më tej, në ankesë theksohet parashtruesja ka aplikuar për votim nga diaspora brenda afatit ligjor dhe se aplikimi i është miratuar nga KQZ, dhe si dëshmi i është dërguar dëftesa e aprovimit ku ka qenë e obliguar të bashkëngjis me materialin e votimit. Tutje, shton se në listën e publikuar nga KQZ më datë 28.09.2025, figuron emri i saj si aplikuses e suksesshme por në listën përfundimtare, emri i është tërhequr pa njoftim zyrtar. Sipas parashtrueses së ankesës e drejta e saj për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe me rregulloren e PZAP-së, nr.01/2025.

Në përgjigje në kërkesë KQZ ka theksuar lidhur me ankesat Anr.23/2025, Anr.24/2025, Anr.25/2025, Anr.26/2025, Anr.27/2025 dhe Anr.28/2025 në vijim gjeni përgjigjen lidhur me aplikimin, verifikimin dhe anulimin e kërkesave për regjistrim.

Anr.23/2025 - Shtetasi [REDAKTUAR] (më tej parashtruesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për

votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesit është njoftuar përmes emailit, në emailit adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDACTED] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2.7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar. Aplikuesi është kontaktuar tri herë në ditë dhe orare të ndryshme dhe nuk është lajmëruar.

Gjithashtu adresa e emailit e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [REDACTED] është përdorur edhe të aplikuesit të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Anr.24/2025 - Shtetasi [REDACTED] (më tej parashtuesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDACTED] ka aplikuar përmes platformës elektronike.

Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDACTED] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2.7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar. Në numrin i cili është dhënë gjatë aplikimit kemi kontaktuar dhe nuk është lajmërua [REDACTED] por një person tjetër i cili nuk ka pranuar të prezantohet dhe të konfirmoj të dhënat e regjistrimit.

Gjithashtu adresa e emailit e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [REDACTED] është përdorur edhe te aplikues të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Anr.25/2025 - Shtetasi [REDACTED] (më tej parashtuesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDACTED] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDACTED] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [REDACTED] është përdorur edhe të aplikues të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Anr.26/2025 - Shtetasi [REDACTED] (më tej parashtuesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDACTED] dhe e lindur me datë 10.04.1996, ka aplikuar përmes

platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [redacted] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [redacted] është përdorur edhe te aplikues të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Anr.27/2025 - Shtetasi [redacted] (më tej parashtuesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [redacted], ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [redacted] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [redacted] është përdorur edhe te aplikues të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Anr.28/2025 - Shtetasi [redacted] (më tej parashtuesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [redacted], ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [redacted] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [redacted] është përdorur edhe te aplikues të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Shtetasja [redacted] (më tej parashtuesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [redacted], ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [redacted] për aprovimin e kërkesës për regjistrim. Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2.7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar. Numri i telefonit i deklaruar gjatë aplikimit nga aplikuesi është përdorur në aplikim tjetër, pra nuk është numër personal, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Numri i telefonit i deklaruar nga aplikuesja është

deklaruar edhe të aplikuesi [REDAKTUAR] i cili është regjistruar para aplikuesës dhe kërkesa e tij është e aprovuar. Pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.23/2025 i datës 09.09.2025, ZL.A.nr.24/2025 i datës 09.09.2025, ZL.A.nr.25/2025 i datës 09.09.2025 ZL.A.nr.26/2025 i datës 09.09.2025, ZL.A.nr.27/2025 i datës 09.09.2025 dhe ZL.A.nr.28/2025 i datës 09.09.2025, ZL.A.nr.28/2025 i datës 09.09.2025 janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë të përbashkët ZL.A.nr.23/2024, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve. Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave të parashtruara nga ankuesit, vëren se të njëjtat janë të pa bazuara. Paneli, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi se ankesat e ankuesve janë të pabazuara, pasi që parashtruesit i ankesave gjatë aplikimit të tyre për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *"4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1..."*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se parashtruesit e ankesave, gjatë aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, nga verifikimi i këtyre dëshmimeve paneli vëren se Email adresat e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, dhe si e tillë është në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e ngjashme e cila fillon me [REDAKTUAR] është përdorur edhe te aplikues të tjerë, prej të cilave ka pasur edhe mbiemra të ndryshëm nga ai i aplikuesit.

Ndërsa lidhur me ankesën e Shtetases [REDAKTUAR] me numër personal të Republikës së Kosovës [REDAKTUAR] përkatësisht pretendimet ankimore të ankueses se praktika e heqjes së qytetareve nga lista është e padrejtë dhe e pajustificueshme, pasi mos përgjigja në telefon nuk mund të jete kriter për heqjen e qytetarin nga lista votuese. Këto pretendime Paneli pasi shqyrtoj shkresat të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka refuzuar si të pabazuara për arsye se, në baze të kriterëve të përcaktuara me nenit 3 prag 5.1

të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 'Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës' ku nder tjerash kërkohet që aplikuesi të plotësojë, *...numrin e telefonit personal*, ndërsa sipas Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ nenit 5. Parag 2.1, përkatësisht DSHV ndërmerr veprime për verifikimin e aplikacioneve të pranuara përmes postës duke përfshirë por pa u kufizuar në video thirrje, telefonata,....". Gjithashtu, numri i telefonit i deklaruar nga aplikuesja është deklaruar edhe të aplikuesi [REDACTED] i cili është regjistruar para aplikuesës dhe kërkesa e tij është e aprovuar, ndërsa ankuesja nuk paraqitur asnjë dëshmi konkrete me të cilën do të dëshmonte një gjendje tjetër faktike të kundërt nga konstatimet e KQZ-së. Andaj paneli konsideron se KQZ ka vepruar drejte kur pas verifikimeve kërkesën e aplikueses e ka anuluar.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale dhe pretendimeve ankimore, PZAP konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesve, andaj pretendimet e ankuesve nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga KQZ-së.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtuesit të ankesëve nuk kanë plotësuar njërën nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nen 3 paragrafi 5 pika 5.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me neni 3 paragrafi 5 pika 5.1 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr. 23/2025 më datën 11.09.2025



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.